

VENDIM
Nr. 771, datë 2.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 276, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES DHE MINISTRIT TË SHETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE, TË PRONËS NR. 33, ME EMËRTIM "SHTËPIA E USHTARAKËVE", ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN "ZHAN D'ARK", TIRANË, PËR VENDOSJEN E QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT (QKR), QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA), SI DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË MARKAVE DHE PATENTAVE (DPPM) E AGJENCISË SË ZBATIMIT TË REFORMËS TERRITORIALE (AZRT)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 276, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në titull dhe në të gjithë tekstin, fjalët "...Qendrës/a Kombëtare të Regjistrimit (QKR), Qendrës/a Kombëtare të Licencimit (QKL)..." zëvendësohen me "...Qendrës/a Kombëtare të Biznesit (QKB)..."

2. Në titull dhe në pikën 1 bëhen këto shtesa:

a) Pas emërimit "...ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike..." shtohen fjalët "... si dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)..."

b) Pas emërimit "...Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM) e Agjencisë së Zbatimit të Reformës Territoriale (AZRT)..." shtohen fjalët "...dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)".

3. Në pikën 2 bëhen shtesat si më poshtë vijon:

a) Në fjalinë e parë, pas fjalëve:

i) "...Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes..." shtohen fjalët "...dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)..."

ii) "...Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave (DPPM)..." shtohen fjalët "...si dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU)".

b) Në fund të shkronjës "a", të pikës 2, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Kati përdhe të përdoret nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave (DPPM), si dhe Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (STKKU), sipas planimetrisë bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e këtij vendimi."

4. Në pikën 4, pas fjalëve "...ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike..." shtohen fjalët "...ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit..."

5. Në pikën 5, pas fjalëve "...ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike..." shtohen fjalët "...ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit..."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE PËR ZYRAT E
STKKU + QKB + DPPM
SH. 1:200



